



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.98/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Faton Ademi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Lutfie M. Ajvazi, duke vendosur përkitazi me ankesën e BIRN, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahën me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 27.09.2019, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet ankesa e organizatës BIRN, me seli në Prishtinë, ndërsa subjektit politik Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 2.500,00 euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Organizata BIRN me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP më datë 26.09.2019, me të cilën pretendon se kandidati për deputet Ilir Ferati, nga radhët e subjektit politik LDK, në postimin e tij në rrjetin social Facebook, ka publikuar një fotografi nga një tubim i fushatës zgjedhore ku shihet kryetari i subjektit politik (LDK), Isa Mustafa, ku shihet duke bërë fushatë me disa fëmijë me llogo të LDK -së. Parashtruesi i ankesës pretendon se me këtë Isa Mustafa, kandidat për Deputet nga radhët e subjektit politik LDK, ka shkelur Kodin e Mirësjelljes.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur një fotografi, nga vendi ku ka ndodhur shkelja e kodit të mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët.

Në përgjigjen në ankesë Lidhjes Demokratike e Kosovës (LDK), të datës 27.09.2019, theksoi se lidhur me ankesën Anr.98/2019 me të cilën iu ka bashkangjitur ankesës ka të bëjë me përmbledhjen e një aktiviteti të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), ku shihet kryetari i

këtij subjekti politik duke bërë fushat me disa fëmij të cilët sipas përgjigjes në ankes janë pjesë e familjes Mustafa, përkatësisht nipat dhe mbesat e Isa Mustafës dhe si e till nuk kanë qenë të përdorur për fushat zgjedhore.

Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre nuk i kanë bashkëngjitur asnjë provë si dëshmi se me të vërtet bëhet fjalë për antarët e familjes Mustafa.

Subjekti politik LDK kërkon nga PZAP-i që ankesa e bërë ndaj tyre nga BIRN të hudhet e palejuar sepse fotografia e bërë është bërë si fotografi familjare.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli nga fotot e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se Isa Mustafa, nga radhët e subjektit politik LDK, ka përdorur fëmijë në një tubim për fushatë zgjedhore dhe i janë postuar në rrjetin social Facebook nga kandidati i të njëjtit subjekt politik Ilir Ferati, veprim ky që është në kundërshtim me zgjedhjet e nenin 2 pika 5.3 e Riformular pika b), c) dhe d), të Rregullës Zgjedhore nr.20/2019 mbi ndryshimin dhe plotësimin e rregullores zgjedhore nr.13/2013 të KQZ-së, që në rastin konkret, personat nën 18 vjet bartin material promovues gjatë fushatës zgjedhore, ku të njëjtit kanë vendosur kapela me mbishkrim LDK.

Paneli me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik LDK, nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se të njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për t'u përgjigjur, ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre, nuk e kanë pranuar shkeljen e supozuar, me arsyetimin e tyre se në foton e bashkëngjitur shihen mbesat dhe nipat e Kryetarit të LDK-së, Isa Mustafa, të cilët kanë qenë bashkë me gjyshin dhe gjyshen, fëmijët nuk kanë qenë të përdorur në fushat, pasi kanë pas edhe prindërit e tyre si kujdestarë. PZAP mori parasysh pretendimet e tilla, pretendime të cilat nga ana e panelit janë të paqëndrueshme dhe nuk kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij

vendimi. Me këtë vendim dhe shqiptim të gjobës paneli vendosi se do të ndikon te subjekti politik që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa

Anr. 98/2019 më datën 27.09.2019

Kryesuesi i Panelit

Fejzullah Rexhepi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.